



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva / Ministry of Health
Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
Nacionalni Institut Javnog Zdravstva Kosova
National Institute of Public Health of Kosovo

Njësia org. 03
Org. Jedin. 20
Org. Unit
Nr. i faqeve
Br. Stranka
No. Page

Nr. Prot. 1415
Br. Prot.
Prot. No
Data 15.07.2025
Datum
Date

Ministria e Shëndetësisë
Ministry of Health

Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva / Ministry of Health

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

Nacionalni Institut za Javno Zdravstvo Kosova / National Institute of Public Health of Kosova

DATË/A:	14.07.2025	
PËR/ZA/TO:	Dr. Ardita Baraku, Drejtor Ekzekutiv, IKShPK	Baraku
PËRMES/PREKO/ THROUGHT:	Dr. Ariana Kalaveshi, Drejtoreshë e Departamentit të Epidemiologjisë, IKShPK	ikshpk
NGA/OD/FROM:	Dr. Pranvera Kaçaniku-Gunga, Epidemiologe, IKShPK	Pranvera
CC:	Znj. Era Pireva, Zyrtare IKShPK	
TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT:	Buletini mujor i sëmundjeve ngjitëse qershor 2025	

E nderuara Dr. Ardita Baraku, Drejtor Ekzekutiv, IKShPK

Ju lutem gjeni të bashkëngjitur Buletinin mujor i sëmundjeve ngjitëse, qershor 2025

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government



Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva / Ministry of Health

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

Nacionalni Institut za Javno Zdravstvo Kosova / National Institute of Public Health of Kosova

BULETINI MUJOR I SËMUNDJEVE NGJITËSE

Qershor, 2025

01-30 qershor, 2025

**PËRMBAJTJA E
BULETINIT**

- Rastet e sëmundjeve ngjitëse gjatë muajit qershor 2024 dhe 2025
- Sëmundjet e raportuara në Kosovë, sipas komunave
- Rastet e spitalizuara nga sëmundjet ngjitëse
- Epidemitë e lajmëruara
- Niveli i raportimit nga institucionet shëndetësore
- COVID-19
- Situata epidemiologjike në rajon dhe botë

QËLLIMI:

Që të përcillet dhe vlerësohet situata epidemiologjike me sëmundje ngjitëse në Kosovë, trendin e sëmundjeve ngjitëse, momentet me valide epidemiologjike, shkallën dhe kualitetin e raportimit të institucioneve shëndetësore me qëllim të përfortimit të parandalimit dhe përgjigjes epidemiologjike.

**1. NUMRI I RASTEVE DHE VDEKJEVE NGA
SËMUNDJET NGJITËSE GJATË MUAJIT QERSHOR
2025 DHE 2024**

Gjatë muajit qershor 2025 janë raportuar **8,861 raste** me sëmundje ngjitëse **Inc.(497.22 raste /100, 000 banorë)**. Ky numër i rasteve është më i ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit **2024 (16,246 raste apo Inc 911.61 raste/100,000)**. Sëmundjet të cilat prijnë me numër më të lartë të rasteve janë: **Sindroma diareale me 4,179 raste ose 234.5/100,000 Influenca sezonale (ILI) me 3,254 raste ose 182.59/100,000 banorë, banorë, dhe ARI/ITPR me 849 raste ose 47.64 në 100,000 banorë (Tab.1).**

Gjatë muajit qershor 2025 janë raportuar 9 raste të vdekjes nga sëmundjet ngjitëse: 7 raste me dg. Infiltratio pulmonum me diagnozë përcjellëse, 1 rast me dg. Meningoencephalitis purulenta dhe 1 rast me dg. AIDS.

2. SËMUNDJET NGJITËSE TË RAPORTUARA NË KOSOVË SIPAS KOMUNAVE, QERSHOR 2025

Gjatë muajit qershor 2025 në IKShPK, nga grupi i sëmundjeve që raportohen me numrin më të lartë, (shih Tabela 1)

Sindroma diareale: Gjatë muajit qershor 2025 në IKShPK janë raportuar 4,179 raste me sindromë diareale (Inc.234.50/100,000 banorë). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak me (8,575 raste), vërehet një ulje prej mbi 50% dhe gjithashtu krahasuar me muajin maj 2025, me 4,452 raste të raportuara, ulje prej 6.1%. Megjithatë numër ky i konsideruar i rasteve të raportuara i cili mbetet shqetësim për shëndetin publik, pasojë kjo e ekspozimit ndaj patogjenëve të ndryshëm në ushqim dhe ujë.

Influenca sezonale /ILI: Gjatë muajit maj 2025 në IKShPK janë raportuar 3,254 raste me ILI (Inc. 182.59/100,000 banorë). Sipas numrit të rasteve të raportuara vërehet rënie prej 44 % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak me (5,818 raste) dhe gjithashtu krahasuar me muajin paraprak, maj 2025 me (6,063 raste të raportuara me ILI) vërehet ulje prej 46.33%, karakteristike kjo për sezonën dhe uljen e aktivitetit të qarkullimit të patogjenëve respirator.

ARI/ITPR: Gjatë muajit qershor 2025 në IKShPK janë raportuar 849 raste me ARI (Inc.47.64/100,000 banorë). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak me (1,240 raste) vërehet ulje prej 8.8% e numrit të rasteve të raportuara dhe gjithashtu krahasuar me muajin paraprak maj 2025 me (995 raste), ulje prej 14.67%.

Variçella: Gjatë muajit qershor 2025 në IKShPK janë raportuar 340 raste me Variçellë (Inc.19.08/100,000 banorë) dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024 me (579 raste) vërehet ulje prej 41.27% e rasteve të raportuara dhe gjithashtu krahasuar me muajin paraprak maj 2025 me 398 raste të raportuara, ulje prej 14.57%.

**Numri i rasteve dhe Incidenca e sëmundjeve ngjitëse të raportuara në Kosovë,
01 – 30 qershor të vitit 2024 dhe 2025**

Tabela 1.

Numri i rasteve dhe incidenca e disa sëmundjeve ngjitëse në Kosovë në periudhën 01 - 30 qershor të vitit 2024 dhe 2025				
Sëmundjet /shkaktarët	Qershor, 2024		Qershor 2025	
	Nr.	Incidenca/ 100.000	Nr.	Incidenca/100.000
COVID-19	5	0.28	1	0.06
ITPR - Pneumonia/ARI	931	52.24	849	47.64
SARI (forma e rëndë e pneumonisë)	11	0.62	8	0.45
Sëmundje e ngjashme me gripin (ILI)	5818	326.47	3254	182.59
Influenca B	1	0.06		0.00
RSV	6	0.34	4	0.22
Diarea acute	8575	481.17	4179	234.50
Variçela	579	32.49	340	19.08
Sindromi meningjeal	14	0.79	16	0.90
EHKK	1	0.06		0.00
Helmimet me ushqim	56	3.14	55	3.09
Rota virus	3	0.17	4	0.22
Salmonella enteritidis	2	0.11	6	0.34
Adenovirus	2	0.11		0.00
Gastroenterokolitet	61	3.42	51	2.86
E.coli	2	0.11		0.00
Hepatiti akut B	3	0.17	4	0.22
Hepatiti akut C		0.00		0.00
Morbilli		0.00	17	0.95
Parotiti epidemik	8	0.45	3	0.17
Pertussis	37	2.08		0.00
Brucelosis	2	0.11	5	0.28
Leptospirosis		0.00		0.00
Toxoplasmosis	2	0.11		0.00
TB**	79	4.43	17	0.95
Sëmundja Lyme		0.00	4	0.22
HIV/AIDS	1	0.06	3	0.17
IST	23	1.29	17	0.95
Cl.Difficile		0.00	3	0.17
Enterovirus		0.00	2	0.11
Giardiaza	1	0.06	5	0.28
*Sëmundjet tjera ngjitëse	23	1.29	14	0.79
Gjithsej	16246	911.61	8861	497.22
*Sëmundjet tjera ngjitëse: Scarlatina, Herpes zoster, Erysipella, Mykozat, Mononucleoza				
** TB-periudha prill-qershor (Q2) 2024				

Grupi i sëmundjeve të raportuara në mënyrë individuale:**Sëmundjet vaksinëpreventabile:**

Nga data 01.06.2025 deri me 30.06.2025 në IKSHPK, janë raportuar 17 raste të konfirmuara me fruth. Nga 17 rastet e raportuara me fruth, 13 prej tyre janë identifikuar si raste index dhe 4 raste kontakte të këtyre rasteve duke treguar një përhapje në komunitet. Nga rastet e raportuara 14 janë të pavaksinuar me vaksinën MMR, përveç N.A.D e vaksinuar me datë 30.05.2025 dhe rastit P.D.J me 28.05.2025 dhe rastit S.L.D. i vaksinuar me 31.05.2024. Shpërndarja sipas komunave: Prishtinë (13 raste), Ferizaj (2 raste) Malishevë (1 rast), Lipjan (1 rast). Sipas grup moshës: 0-1 vjeç (3 raste) që përbëjnë 18% të rasteve 1-2 vjeç (6 raste) që përbën 37% të rasteve, 3-5 vjeç (6 raste) që përbën 37% të rasteve dhe mbi 6 vjeç (2 raste), që përbëjnë 12% të rasteve. Nga rastet pozitive 12 janë testuar në laboratorin e IKSHPK-së dhe 4 në laboratore private. Në SMSN gjatë muajit qershor janë raportuar 15 raste si të dyshimta në fruth. Nga rastet pozitive 5 prej tyre nuk janë raportuar në SMSN, kurse njëri është raportuar në formën manuale.

Gjatë muajit qershor 2025, nga gjithsej 4 raste të testuara si raste të dyshimta me Parotit nga laboratorin mikrobiologjik i IKSHPK-së, janë konfirmuar 3 raste pozitive. Rastet e konfirmuara janë nga komunat: Prishtinë, Skenderaj dhe Malishevë. Sipas grup-moshës 1 rast i takon grup-moshës 1-4 vjeç, 1 rast grup-moshës 5-9 vjeç dhe 1 rast grup-moshës >18 vjeç. Sipas gjinisë 2 raste i takojnë gjinisë mashkullore dhe 1 rast gjinisë femrore. Gjatë hulumtimit epidemiologjik kemi siguruar të dhëna se 2 prej ka status të rregullt vaksinal dhe 1 rast nuk dihet për statusin vaksinal.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe nga 2 raste të testuara si raste të dyshimta me Pertussis, respektivisht 77 raste të testuara si raste të dyshimta me Rubeolë nga laboratorin mikrobiologjik i IKSHPK-së, nuk është konfirmuar asnjë rast pozitiv.

Zoonozat dhe sëmundjet transmise:

Gjatë muajit qershor nga ky grup i sëmundjeve janë testuar 69 mostra në Brucelozë, 20 mostra në Tularemi, 2 mostra në Leptospirozë dhe 110 në Toxoplazmozë. Nga këto mostra të testuara në laboratorin e Mikrobiologjisë në IKSHPK, 5 prej tyre kanë rezultuar pozitiv në Brucelozë.

Sipas komunave rastet me Brucelozë janë : 2 nga komuna e Prizrenit, 1 nga Peja, 1 nga Rahoveci dhe 1 nga komuna e Shtimes. Të gjitha rastet i përkasin gjinisë mashkullore. Sipas moshës rastet i takojnë grup-moshave: 50-59 vjeç (1 rast), 40-49 vjeç (1 rast), 20-29 vjeç (2 raste) dhe 10-19 vjeç (1 rast).

Nga anketimi epidemiologjik i rasteve rezulton se: rastet janë sporadike, pa ndonjë lidhshmëri epidemiologjike. Rastet me Brucelozë janë pasojë e kontaktit me kafshë (dele), dhe përmes ushqimit (djath i ri dhe qumësht i pazier). Për këto raste është njoftuar AUV të cilët kanë vazhduar hulumtimin e mëtejshëm.

Sëmundjet që barten përmes vektorëve - Gjatë muajit qershor janë raportuar 4 raste me borreliozë, prej të cilave 2 raste nga komuna e Prishtinës, 1 rast Kamenicë dhe 1 rast Obiliq. Sipas gjinisë 2 raste të gjinisë e femërore dhe 2 raste të gjinisë mashkullore. Sipas grup moshës nga 1 rast i takon grup moshave 20-29 vjeç, 30-39 vjeç, 40-49 vjeç dhe 60-69 vjeç.

Sindroma meningjeale:

Gjatë muajit qershor, 2025 janë raportuar 16 raste me Sindromë Meningjeale (Mb. 0.89/100 000 banorë), prej tyre 9 raste me Meningjit viral, 7 raste me Meningjit bakterial. Ky numër i rasteve të raportuara është më i lartë krahasuar me periudhën

e vitit 2024, ku ishin të raportuara gjithsej 14 raste (prej tyre 12 raste me Meningjit akut viral dhe 2 raste me Meningjit bakterial).

Sipas komunave, 5 raste janë raportuar në komunën e Prishtinës, 2 raste Prizren, kurse me nga 1 rast komunat: Ferizaj, Gjiilan, Fushë Kosovë, Podujevë, Deçan, Drenas, Kamenicë, Klinë dhe Skenderaj. Nga mostrat humane të testuara në laboratorët e Mikrobiologjisë në IKShPK në LCS janë izoluar 3 raste me HHV7, 2 raste me *Streptococcus pneumoniae*, 1 rast me *Hemophilus influenzae*, 1 rast me Human adenovirus, 1 rast me Human Parvovirus B19 dhe 1 rast me Zoster virus.

Gjatë kësaj periudhe kohore është raportuar 1 rast i vdekjes me dg. Meningoencephalitis purulenta, nga komuna e Shtimes, 76 vjeç, i gjinisë mashkullore me sëmundje tjera përcjellëse.

Sëmundjet që barten me ujë dhe ushqim:

Gjatë muajit qershor 2025, përmes SMSN nga regjioni i Prishtinës janë raportuar: 275 raste me dg. Diarea dhe gastroenteritet me origjinë infektive të supozuar (A09); 22 raste me Intoksikacionet tjera alimentare bakteriale (A 05); 5 raste me dg. Intoksikacionet tjera alimentare bakteriale (A04.9); 2 raste me dg. *Salmonella* (*Salmonella* spp.) (A02.0) dhe 2 raste me dg. Infeksionet tjera intestinale bakteriale me shkaktarë të paspecifikuar (A04.8).

Sipas shkaktarëve të izoluar në Laboratorin e Mikrobiologjisë në IKShPK dhe Kl. Infektive, janë raportuar:

- 1) 4 raste me *Salmonella* Enteritidis prej të cilave sipas komunave janë: 2 raste Prishtinë dhe 2 raste Ferizaj. Sipas grup moshave 2 raste janë të grup moshës 10-19 vjeç dhe 2 raste të grup moshës 60-69 vjeç. Ndërkaq sipas gjinisë 2 raste janë të gjinisë femërore dhe 2 raste të gjinisë mashkullore.
- 2) 5 raste me Rotavirus prej të cilave sipas komunave janë: 1 rast Prishtinë, 1 rast Mitrovicë, 1 rast Fushë Kosovë, 1 rast Vushtrri dhe 1 rast Rahovec. Sipas grup moshave të pesë rastet janë të grup moshës 0-9 vjeç. Ndërkaq sipas gjinisë 2 raste janë të gjinisë femërore dhe 3 raste të gjinisë mashkullore.
- 3) 2 raste me Enterovirus, prej të cilave sipas komunave janë 2 raste nga komuna e Prishtinës, Sipas grup moshave të dy rastet janë të grup moshës 0-9 vjeç. Ndërkaq sipas gjinisë 1 rast i gjinisë femërore dhe 1 rast i gjinisë mashkullore.
- 4) 4 raste me *Clostridium difficile*, prej të cilave sipas komunave janë: 2 raste Prishtinë dhe 1 rast Fushë Kosovë dhe 1 rast Vushtrri. Sipas grup moshave 2 raste të grup moshës 30-39 vjeç dhe 1 rast i grup moshës 20-29 vjeç dhe 1 rast i grup moshës 60-69 vjeç. Ndërkaq sipas gjinisë 2 raste të gjinisë femërore dhe 2 raste të gjinisë mashkullore.

Sëmundjet/Infeksionet respiratore

Gjatë muajit qershor 2025, nga qendrat sentinel janë testuar 104 mostra të dyshimta në Influençë dhe patogjenët tjerë respirator. Nga mostrat e testuara nuk është konfirmuar asnjë rast pozitiv me *Influençë A* dhe *B*.

Nga patogjenët tjerë respiratorë janë raportuar vetëm 4 (3.84%) mostra pozitive me RSV.

Mbikëqyrja me Influençë dhe patogjenët tjerë respiratorë vazhdon sipas rekomandimeve të ECDC dhe OBSH për Influençë me të dhënat e përditësuara nga mbikëqyrja epidemiologjike dhe virologjike. Duke pasur parasysh mungesën e sezonalitetit të parashikueshëm të SARS-CoV-2 dhe potencialin për rritje të aktivitetit edhe gjatë muajve pranverë dhe verë, mbikëqyrja aktive duhet të vazhdojë gjatë gjithë vitit, në përputhje me udhëzimet e ECDC dhe OBSH.

Intensiteti i Influcencës Sezonale për muajin qershor 2025 paraqitet në nivel të ulët të aktivitetit të qarkullimit. Gjatë këtij muaji nuk është raportuar asnjë rast pozitiv. Ky nivel i ulët i qarkullimit është në përputhje me tendencën sezonale të kësaj periudhe të vitit. Rastet pozitive në virusin sincicial (RSV) sipas komunave dhe grupmoshës : Fushë Kosovë (2 raste), Prishtinë (1 rast) dhe Lipjan (1 rast).

Sa i përket moshës, 3 raste pozitive me RSV i takojnë grup-moshës 0-4 vjeç dhe 1 rast i takon grup-moshës 51-64 vjeç.

Gjatë muajit qershor 2025, përmes raportimit nga Kl. Infektive, u raportuan gjithsej 8 raste me SARI. Të gjithë këta pacientë, sipas protokollit dhe kërkesave të klinikistit, u testuan së paku në tre viruse respiratore, SARS-CoV-2, Influenca dhe RSV. Prej tyre asnjëri nuk rezultoi pozitiv në viruset e lartpërmendura.

Rastet SARI sipas komunave janë: Prishtinë (3 raste), Vushtrri (2 raste) dhe me nga një rast komunat: Gjilan, Fushë Kosovë dhe Lipjan. Numri më i lartë i rasteve SARI sipas grup moshës është : mbi 65 vjeç (5 raste), 51-64 (2 raste) dhe 35-50 (1 rast). Sipas gjinisë, 5 prej tyre i takojnë gjinisë mashkullore dhe 3 gjinisë femërore.

Gjatë muajit qershor 2025, janë shënuar 7 raste të vdekjes nga SARI (CFR=87.5%).

Rastet e vdekjes i përkasin komunave si : Prishtinë (3 raste), Gjakovë (1 rast), Podujevë (1 rast), Kamenicë (1 rast) dhe Gjilan (1 rast), i takojnë grup-moshës: mbi 65+ (3 raste), 51-64 (2 raste) 35-50 vjeç (2 raste).

Në SMSN, gjatë muajit qershor 2025, janë raportuar 17 raste me Tuberkuloz apo 0.95 në 100,000 banorë. Sipas komunave: Prishtinë (9 raste), Pejë (3 raste), Prizren me 2 raste kurse Mitrovicë, Ferizaj dhe Lipjan me nga (1 rast). Prej 17 rasteve të raportuara, 14 (82.3%) janë raste pulmonare dhe forma ekstrapulmonare 3 (17.6%). Nga forma pulmonare, të konfirmuara bakteriologjikisht janë 7 raste (41.1%). Sa i përket grup- moshës, gjatë kësaj periudhe, rezulton grup- mosha më e prekur është ajo 60-69 vjeç me 8 raste apo (43.7%), grup moshat 50-59 vjeç me 3 raste apo (17.6%), grup mosha 30-39 vjeç dhe 40-49 vjeç me nga 2 raste apo (11.7%), kurse grup- moshat: 10-19 vjeç dhe 20-29 vjeç me nga 1 rast apo (5.8%). Sipas gjinisë, rezulton se 64.7 % (11 raste) i takojnë gjinisë mashkullore dhe gjinia femërore me 35.3% (6 raste).

Rastet me HIV/AIDS/IST, qershor 2025

Gjatë muajit qershor 2025, janë raportuar 3 raste me HIV. Dy raste i takojnë gjinisë mashkullore (i përkasin grup moshës 35-44 vjeç) kurse 1 rast i përket gjinisë femërore (i përket grupmoshës 55+).

Rruga e transicionit të tek 2 raste të raportuara, është homoseksuale (MSM) kurse tek 1 rast është ajo heteroseksuale.

Rastet e raportuara janë nga komunat Prishtinë, Fushë Kosovë dhe Lipjan.

Gjatë muajit qershor 2025, është raportuar një exitus si pasojë e AIDS-it, përmes postës elektronike nga ana e Klinikës Infektive. Rasti me HIV infeksion, në fjalë, është konfirmuar dhe raportuar për herë të parë në IKShPK/Departamenti i Epidemiologjisë me 06.12.2018 dhe i takon grup moshës 45-54 vjeç, komuna Gjakovë, popullata kyçe MSM. Gjatë vitit 2025 ky është rasti i parë i vdekjes si pasojë e AIDS-it

Ecuria e Infeksioneve Seksualisht të Transmetueshme (IST), qershor 2025

Gjatë muajit qershor 2025 janë raportuar gjithsej 17 raste me Infeksione Seksualisht të Transmetueshme. Rastet e raportuara janë nga komunat: Pejë 9, Prishtinë 6, Vushtrri 1 dhe Gjilan 1.

Rastet e raportuara nga Prishtina, Vushtrria dhe Gjiçani, sipas diagnozës: Sifilis 3 raste, Condyloma 3 raste, Chlamydia 1 rast dhe Herpes 1 rast. Sipas gjinisë: 5 raste i takojnë gjinisë mashkullore dhe 3 raste gjinisë femërore. Grup moshës 25-49 vjeç i takojnë 14 raste dhe grup moshës 15-24 vjeç 5 raste. Të gjitha rastet janë raportuar përmes SMSN.

Nga QRShP Pejë janë raportuar 9 raste të infeksioneve seksualisht transmissive nga komuna e Pejës. Sa i përket shkaktarit, 6 raste janë infeksione me Chlamydia trachomatis dhe një rast infeksion me Neisseria gonorrhoeae. Poashtu me SMSN është raportuar një rast i Sifilizit dhe një rast i Herpesit gjenital nga komuna e Pejës.

Hepatiti akut B dhe Hepatiti akut C, qershor, 2025

Gjatë muajit qershor, 2025, janë raportuar 4 raste me Hepatit akut B. Komuna e Prizrenit 3 raste dhe 1 rast komuna e Skenderajt. Sipas gjinisë 2 raste i takojnë gjinisë femërore dhe 2 raste gjinisë mashkullore.

Me Hepatit akut C, gjatë kësaj periudhe nuk është raportuar asnjë rast.

Rastet e sëmundjeve ngjitëse në Kosovë sipas komunave, qershor 2025

Tabela 2.

Annex 1. Rastet e sëmundjeve ngjitëse sipas komunave, qershor 2025																													
SËMUNDJA	Sindroma meningjeale																												
KOMUNA	Pneumonia/ARI	SARI	ILI	Diarrhea ac	Variçella	RSV	COVID-19	Meningji t aëroas	Meningji t purulent	Meningo encephal it ac.	Meningo encephal itis purulent a	**Morbilli	Parotitis epidemic a	Hepatit ac. B	Helminth me ushqim	Gastroe nterokol itet	Brucellos a	Salmonel loza	Rotavirus	Boreliosa (Lyme Disease)	Enterovirus	Cl.difficile	IST	HIV	TB	Giardia za	Sëm.tj er a ngjitëse	Totali	
DEÇAN	4		18	63	10			1							11												2	109	
DRAGASH	24		154	18	1																							197	
DRENAS	42		30	65	7					1					1	4												150	
F. KOSOVË	1	1	27	55		2					1				2	7			1			1		1			1	100	
FERIZAJ	5		74	164	7					1			2					2		1						1		256	
GJAKOVË	4		36	38	3																							81	
GJILAN	17	1	254	290	30					1													1					594	
GRAÇANICË																												0	
H. I ELEZIT				6																								6	
ISTOG	0		37	32																								69	
JUNIK	0		6	6																								12	
KACANIK	1		10	28	10											1												50	
KAMENICË			291	161				1													1							454	
KLINË	18		24	52	19					1					3	2												119	
KLOKOT																												0	
LEPOSAVIQ																												0	
LIPJAN		1		4	2	1						1	1		1	1								1	1		1	15	
MALISHEVË			19	14	5							1				4										1		44	
MAMUSHË			2	12	4																							18	
MITROVICË	41		318	605	17								1					2	1						1		1	987	
MITROVICË E VERIUT																												0	
N. BËRDË			20	13													1											34	
OBILIQ			31	57	7										1						1							97	
PARTESH																												0	
PEJË	1		345	310	33										1		1						9			3	2	1	706
PODUJEVË	5		172	84	8			1								7											4	281	
PRISHTINË	608	3	744	990	61	1	1	5				13	1		28	23		2	1	2	2	2	2	6	1	9	2	2505	
PRIZREN	14		119	514	55			1		1				3	6		2									2	2	721	
RAHOVEC			17	19	1												1		1									39	
RANILLUG																												0	
SHTËRPCE																												0	
SHTIME	21		94	70	11												1											197	
SKËNDERAJ	17		9	39	2					1				1														69	
SUHAREKË	10		204	294	22																							530	
VITI			199	150	21																							370	
VUSHTRRI	16	2	0	26	4										1	1							1					51	
Z. POTOK																												0	
ZVEÇAN																												0	
BURGU I LIPJANIT																												0	
PA ADRESË																												0	
TOTALI	849	8	3254	4179	340	4	1	9	4	2	1	17	3	4	55	51	5	6	4	4	4	2	3	17	3	17	5	14	8861

*Sëmundjet tjera ngjitëse: Herpes zoster, Mykozat, Mononucleoza


3. RASTET E SPITALIZUARA NË KLINIKËN INFEKTIVE, PEDIATRI DHE SPITALET RAJONALE NGA SËMUNDJET NGJITËSE NË KOSOVË GJATË MUAJIT QERSHOR 2025

Rastet e spitalizuara nga sëmundjet ngjitëse në numër më të madh janë raportuar nga diaretë akute dhe gastroenterokolitet nga të cilat vetëm disa kanë konfirmim laboratorik të shkaktarit pasuar nga pneumonitë, infeksionet virale të traktit respiratorë, të cilat raportohen sipas diagnozës klinike. (shih tabela 3).

Rastet e spitalizuara në Klinikën Infektive, Pediatri dhe spitalet rajonale nga sëmundjet ngjitëse në Kosovë, gjatë muajit qershor 2025

Tabela 3.

Sëmundja	Rastet
Pneumonia /ARI	95
SARI	8
Hepatitis B	4
Sindroma meningjeale	16
Helmimet me ushqim	30
Diarea akute dhe gastroenterocolite	245
Status febrilis	18
Exanthema	4
Mononucleosis	1
Erysipela	12
Vulnus morsum viperi	6
Total	439



4. EPIDEMITË E LAJMËRUARA GJATË MUAJIT QERSHOR 2025

Epidemia kolektive me Helmim në ushqim në Gjilan

Me datën 02.06.2025, nga Reparti Infektiv i SR-Gjilan njoftohet QRSHP Gjilan, për hospitalizimin e 15 rasteve të dyshimta në Helmim me ushqim, nga data 30.05.2025 deri më 01.06.2025), të cilën kanë konsumuar ushqim në Picerinë "N.N." Gjilan. Pas anketimit të 13 pacientëve të hospitalizuar, kuptojmë që kanë konsumuar ushqim të më datë 28-29.05.2025, që nga mëngjesi e deri në mbrëmje, sendviç me mish të pulës dhe sos, (një ka konsumuar picë me suxhuk, kashkavall, sos, keqap dhe majonez). Të gjithë pacientët kishin: temperaturë, ethe, kokëdhimbje, plogështi, gërqe, mundim, vjellje, barkëqitje të shpeshta ujore, ndryshimi i ngjyrës së feqeve, etj.

Pas anketimit të rasteve të hospitalizuara janë informuar Inspektorët Sanitar për ndërmarrjen e masave dhe së bashku me ekipin e QRSHP-së, vizituan picerinë në fjalë, ku janë marrë strishot e ambientit të lokalit dhe u bë mbyllja e tij nga ana e Inspektorëve sanitar. Nga të anketuarit, 5 ishin meshkuj apo 38.46 % dhe 8 femra apo 61.5% dhe grup-mosha më e atakuar ishte: 10-14 vjet (2 raste), 15-19 vjet (3 raste), 20-29 vjet (5 raste), ndërsa grup-moshat tjera me nga 1 rast.

Një 7 mostër e koprokulturës rezultoi me *Salmonella enteritidis*, ndërsa tri të tjerat me *Candida spp.* Poashtu janë marrë mostrat për koprokulturë edhe nga pacientët tjerë por pas marrjes së terapisë dhe kanë rezultuar me florë të çrregullt intestinale.

Epidemia kolektive me Helmim në ushqim në Podujevë

Epidemia kolektive në Podujevë ka filluar më datë 17.06.2025 rreth orës 11:00 dhe është raportuar më 18.06.2025 rreth orës 14:30 nga Emergjencën e vjetër QKMF-Podujevë, për disa pacientë me simptoma: vjellje, barkëqitje, marramendje, dhembje shpine. Gjatë hulumtimit epidemiologjik, kuptohet se rreth 60 persona të kompanisë "N.N." kanë konsumuar ushqim në të njëjtin restorant-gjellëtorë, prej të cilëve afërsisht 20 prej tyre kanë shfaqur simptoma. Ushqimi i konsumuar përbëhej nga: mish pule, mish viçi, pleskavicë si dhe sallatë (marullë) dhe gullash me pure. Simptomat si: temperaturë, ethe, vjellje, barkëqitje ujore, kokëdhimbje dhe dhimbje shpine, janë shfaqur po të njëjtën ditë, në intervalin kohor 15:00 – 15:30, ndërsa tek rasti i fundit më 20.06.2025 rreth orës 20:00. tjera: temperaturë, ethe, vjellje, barkëqitje ujore, kokëdhimbje dhe dhimbje shpine, janë shfaqur të nesërmen më 18.06.2025, në intervalin kohor 06:00 – 11:00.

Në Klinikën Infektive në QKUK kanë kërkuar ndihmë mjekësore 6 pacientë me dg. Intoxicatio alimentaris, kurse 10 pacientë në QKMF-Podujevë. Të gjitha rastet janë nga Komuna e Podujevë.

Nga 16 rastet e raportuara, 14 prej tyre janë punëtorë të kompanisë Sh.P.K."N.N", kurse 2 prej tyre janë punëtorë në restorant-gjellëtorë "N.N", Podujevë. Gjithsej në restorant-gjellëtorë janë të punësuar 8 punëtorë, prej tyre 4 kamarierë dhe 4 kuzhinier. Nga pacientët e hospitalizuar në Klinikën infektive janë marrë mostra të fecesit për analizë në laboratorin e

Mikrobiologjisë në Klinikën Infektive si dhe 2 raste tjera kanë dërguar koprokulturën në laborator privat. Nga rezultatet deskriptive, në bazë të raportimit, të ekspozuar ishin 200 persona, prej të cilëve 20 (shkalla e sulmit 10%) me simptoma gastrointestinale, dhe prej tyre 6 raste u hospitalizuan në Klinikën Infektive të QKUK-ës. Sa i përket grup-moshave: 10 raste i takojnë grup-moshës 20-29 vjeçare, 4 raste grup-moshës 40-49 vjeçare dhe 2 raste i takojnë grup-moshës 50-59 vjeçare, kurse grupmoshat tjera nuk janë raportuar. Nga rezultatet laboratorike në laboratorin privat në Podujeve tek dy mostra të marra të koprokulturës, tek të 2 pacientët është izoluar *Sallmonella enteritidis*. Në laboratorin e Mikrobiologjisë në Klinikën Infektive të QKUK-ës dhe QLT në IKShPK raportohen rezultatet si më poshtë: nga mostrat humane të fecesit të pacientëve të hospitalizuar nuk janë izoluar baktere patogjene. Në mostrat e ushqimit nuk janë izoluar bakterie patogjene. Nga mostrat e ambientit, nuk janë izoluar baktere patogjene.

Për rastet në fjalë është njoftuar Inspektoratit Sanitar më datë 18.06.2025 të cilët më datë 19.06.2025, së bashku me ekipin nga Departamenti i Ekologjisë humane dalin në teren, janë marrë mostrat nga ushqimi dhe strisho nga ambienti i punës të cilat janë sjellë me datë në IKShPK në Labororet referente, me urdhër të inspektoratit Restoranti në fjalë është mbyllur.

Epideminë kolektive në Ferizaj

Me datë 22.06.2025 QRShP Ferizaj, informohet nga Inspektorati Sanitar përmes IKShPK, bazuar në raportet 24 orëshe të rasteve të hospitalizuara të Klinikës Infektive – QKUK, për hospitalizimin e 4 (katër) pacientëve me dg. Gastroenterocolitis acuta, nga Ferizaj. Gjithashtu, në QKMF Ferizaj ndihmë ambulantore kanë kërkuar edhe 4 persona të tjerë me simptomatologji të ngjashme. Të njëjtit kanë konsumuar ushqim (senduiq me sallatë dhe me sos, qofte me sallatë). Pacientët, fillimisht kishin kërkuar ndihmë mjekësore në QKMF - Ferizaj dhe pasi gjendja shëndetësore e tyre nuk përmirësohet, 4 prej tyre referohen për në Klinikën Infektive QKUK. Ushqimi është konsumuar, duke filluar nga ora 20⁰⁰ të datës 18.06.2025 ndërsa simptomat kanë filluar të nesërmen në mëngjes të dt: 19.06.2025. Të gjithë pacientët kanë pasur simptoma si: temperaturë, ethe, barkqitje, vjellje, fryerje barku dhe mundim, gërrqe, barkqitje ujore. Ekipa e QRShP Ferizaj në bashkëveprim me Inspektoratin Sanitar kanë vizituar me datë 22.06.2025 në ora 11:30, restorantin “N.N. në Rr. Driton Islami në Ferizaj me ç’rast janë marrë 7 mostra/strisho për vlerësimin e kushteve higjieniko - sanitare nga ambienti i kuzhinës, në enë, në tavolina të punës, në aparate të përgatitjes së ushqimit, si dhe nga uniformat dhe duart e kuzhinierëve, të cilat janë sjellë po atë ditë në laboratorin e QRShP-së për analizë dhe 3 mostra të ushqimit: majonez i përgatitur në restorant, sos me shmand poashtu i përgatitur në restorant dhe qebapa. Me urdhër të Inspektoratit Sanitar, është rekomanduar që prej orës 20⁰⁰ të mbyllet lokali dhe të bëhet një DDD dhe një pastrim gjeneral. Rezultatet deskriptive: Në restorant gjatë 24 orëve shërbehen afërsisht 300 shujta, 10 raste kane shfaqur simptoma gastrointestinale të cilët kanë kërkuar ndihmë mjekësore (shkallë sulmi 3.33%). Nga 10 raste të raportuara janë anketuar 10 raste (100%). Sa i përket simptomatologjisë, kryesisht kanë dominuar rastet me 3 e më shumë simptoma në të njëjtën kohë si: vjellje, diarre ujore, mundim, temperaturë, ethe dhe kokëdhembje. Sipas gjinisë: femra 8, mashkuj 2. Janë hospitalizuar 4 raste, të tjerët janë trajtuar në mënyrë ambulantore. Rezultatet laboratorike: Në Laboratorin e Mikrobiologjisë në Klinikën Infektive të QKUK-së, janë dërguar për analizë 4 mostra të fecesit të marra nga rastet e hospitalizuara dhe në 2 mostra është izoluar *Sallmonella enteritidis*. Në laboratorin e Mikrobiologjisë në IKShPK, nga 3 mostrat e ushqimit të analizuar, në mostrën me Majonez është izoluar *Sallmonella* spp. Mostra e ujit e cila është analizuar nga aspekti fiziko- kimik dhe bakteriologjik është brenda standardeve për ujin për konsum njerezor UA 10/2021. Nga strishot e marra në ambientet e lokalit, nga mjetet e punës, enët, aparatet dhe personeli, prej 7 strishove nuk janë izoluar baktere patogjene.

Epidemia kolektive me Helmim me ushqim në Prishtinë

Me datë 26.06.2025, Departamenti i Epidemiologjisë i Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike në Kosovë (IKShPK), gjatë anketimit të rasteve në Klinikën Infektive është njoftuar për 3 raste me simptoma gastrointestinale dhe me lidhshmëri epidemiologjike. Të gjitha rastet kishin konsumuar ushqim në lokalit “N.N.”, në Prishtinë, mes datës 24 dhe 25 qershor 2025. Deri me datë 02.07.2025 në Klinikën e Sëmundjeve Infektive në Qendrën Klinike Universitare, janë hospitalizuar 23 raste

me simptome gastrointestinale pas konsumimit të ushqimit në lokalin e lartpërmendur ndërsa 8 të tjerë janë trajtuar në mënyrë ambulantore.

Ekipi i IKSHPK-së me datë 26.06.2025 filloi hulumtimin për të vlerësuar shkallën e epidemisë, për të identifikuar burimin e mundshëm të transmetimit dhe për të inicuar masat e duhura të kontrollit. Është përcaktuar rast personi që ka konsumuar ushqim në lokalin "N.N.", dhe ka shfaqur simptoma gastrointestinale, duke përfshirë: temperaturë, ethe, vjellje, barkqitje ujore dhe dhembje barku në periudhën kohore 24 – 29 qershor. Janë anketuar të gjitha rastet e hospitalizuara dhe të njëjtit u pyetën për numrin e përgjithshëm të familjarëve që kishin konsumuar ushqim në "N.N.". Përmes SMSN janë hulumtuar raportimet e rasteve me simptome dhe diagnoza gastrointestinale. Përmes anketës epidemiologjike u mbledhën informacione të tilla si të dhënat demografike, simptomat e sëmundjeve gastrointestinale, datën dhe orën e shfaqjes së simptomave, shtrimin në spital, trajtimin dhe ushqimin e konsumuar. Mbledhja e të dhënave u krye me anketim të drejtpërdrejtë ose përmes telefonatave tek personat e trajtuar në mënyrë ambulantore. Simptomat gastrointestinale u paraqitën në mesin e personave që konsumuan ushqim në lokalin në fjalë" në datë 24 dhe 25 qershor 2025. Ushqimi i konsumuar përbëhej nga: hamburger me pleskavicë, sallatë, keqap dhe majonez, qofte, sallatë, mish pule dhe qebapë. Ushqimi ishte konsumuar nga ora 10⁰⁰ e datës 24 qershor deri në orën në orën 18⁰⁰ të datës 25.06.2025. Hulumtimi laboratorik: Të gjithë të anketuarve që raportuan sëmundje gastrointestinale iu kërkua të siguronin një mostër për KK, të cilat u dorëzuan në Laboratorin e Mikrobiologjisë dhe u testuan për të gjithë patogjenët e dyshuar që shkaktojnë helmim me ushqimi. Më datë 26.06.2025 pas njoftimit, Inspektorati sanitar së bashku me mostrues nga IKShPK inspektuan kuzhinën e restorantit dhe hetuan praktikën e trajtimit të ushqimit. Janë marrë 10 strisho nga hapësirat e punës në kuzhinë si dhe 3 mostra të ushqimit për analiza mikrobiologjike dhe kimike në IKShPK. Me urdhër të inspektoratit me datë 26.06.2025, është marrë vendimi për mbyllje të përkohshme të subjektit deri në rezultatet e analizave laboratorike mikrobiologjike. Nga 200 shujta ditore (të raportuara nga pronari i lokalit) të cilat ofrohen gjatë ditës në këtë lokal, 31 (15.5%) raste patën simptome gastrointestinale. Janë anketuar 31 (100%) individë.

Tetëmbëdhjetë raste (58%) prej tyre ishin femra; ndërsa numri më i madh i rasteve 10 (33%) i takon grup moshës 30-39 v. Simptomat kryesore të rasteve ishin: temperaturë/ethe dhe plogështi 23 raste (74.1%), diarre 25 raste (80.6%), dhimbje barku raste (45.1%), të vjella 22 raste (70.9%).

Rezultatet laboratorike

Në laboratorin e Ekologjisë Humane nga mostrat të cilat janë marr në teren, janë izoluar këta shkaktarë: *Salmonella* spp. – te lakra në sallatë, *Staphylococcus aureus*, *E.Coli* tek maza me origjinë shtazore, *Escheria coli* nga strisho e rubinetit të banaku. Në laboratorin e Mikrobiologjisë të Klinikës Infektive, në koprokulturën e pacientëve është izoluar *Salmonella enteritidis* – te 10 pacientë.

5. NIVELI I RAPORTIMIT NGA INSTITUCIONET SHËNDETËSORE

Për këtë periudhë, kanë raportuar 29 komuna ose 76.31% (29/38) e tyre.

Komunat të cilat nuk kanë raportuar: Graçanicë, Klokot, Leposaviq, Mitrovicë e veriut, Partesh, Ranillug, Shtërpce, Zveçan dhe Z.Potok.

Tabela 4. Raportimi i sëmundjeve ngjitëse nga institucionet përmes SMSN, qershor 2025


KOMUNA	Spitali i përgjithshëm	Klinika Infektive	Klinika e Pediatrisë	Klinika e Dermatovenereologjisë	Klinika e Pulmologjisë	Institucionet private	QKTGJ	QKMF	QMF	AMF	Gjithsej
DEÇAN								17			17
DRAGASH											
DRENAS								9			9
F. KOSOVË								67	37		104
FERIZAJ								1	4		5
GJAKOVË	20					34		36	49		139
GJILAN	8							14			22
GRAÇANICË											
H. I ELEZIT								5			5
ISTOG								5			5
JUNIK								4			4
KAÇANIK								7			7
KAMENICË											
KLINË								7			7
KLOKOT											
LEPOSAVIQ								0			
LIPJAN								7			7
MALISHEVË								38			38
MAMUSHË											
MITROVICË								2			2
MITROVICË E VERIUT											
N. BËRDË											
OBILIQ								91	5		96
PARTESH											
PEJË	2							13			15
PODUJEVË								56	12		68
PRISHTINË		140	3	4	5	3	1	24	191		371
PRIZREN	36							34			70
RAHOVEC						4		37			41
RANILLUG											
SHTËRPCE											
SHTIME											
SKËNDERAJ								9			9
SUHAREKË											
VITI								33			33
VUSHTRRI	58							33			91
Z. POTOK											0
ZVEÇAN											0
Gjithsej											1165

Gjatë muajit qershor 2025, përmes SMSN janë raportuar gjithsej 1,165 raste me sëmundje ngjitëse. Ky numër krahasuar me numrin e rasteve të raportuara me kopje fizike shënon një rritje prej 13.14 % të rasteve të raportuara përmes SMSN.

6. COVID-19

Gjatë muajit qershor 2025, janë testuar 264 mostra të dyshimta në SARS-CoV-2 dhe prej tyre është raportuar 1 rast pozitiv me SARS-CoV-2 dhe krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024 (5 raste pozitive të raportuara), vërehet një ulje e rasteve. Rasti i konfirmuar i përket komunës së Fushë Kosovës, grup-moshës 50-59 dhe gjinisë femërore. Gjatë muajit qershor 2025 nuk është raportuar asnjë rast i vdekjes nga COVID-19.

Grafikoni 1. Numri i rasteve të testuara, të konfirmuara me COVID-19, qershor 2025



7. SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE NË RAJON DHE BOTË, QERSHOR 2025

Mpox në BE/EEA, shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqi – 2022–2025

Që nga përditësimi i fundit më 19 maj 2025 dhe që nga 19 qershori 2025, janë raportuar 81 raste të Mpox nga 14 vende të BE-së/EEA-së: Gjermania (29), Franca (14), Spanja (8), Italia (7), Holanda (7), Portugalia (4), Austria (2), Çekia (2), Malta (2), Polonia (2), Belgjika (1), Irlanda (1), Luksemburgu (1) dhe Suedia (1). Që nga 19 maji 2025, asnjë vend i ri nuk ka raportuar raste të konfirmuara.

Që nga 19 maji 2025, dy vende të reja të Ballkanit Perëndimor kanë raportuar raste të konfirmuara (Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria).

Numri i infeksioneve të reja të raportuara në Sistemin Evropian të Mbikëqyrjes (TESSy) ka rënë krahasuar me periudhën e fundit të raportimit dhe numri i përgjithshëm mbetet relativisht i ulët në BE/EEA.

Ka të ngjarë që rastet e mpox për shkak të kladës I të MPXV do të vazhdojnë të futen në BE/EEA dhe është e rëndësishme të rritet ndërgjegjësimi në lidhje me importimin e mundshëm të rasteve, si midis udhëtarëve që kthehen nga vendet afrikane të prekura, ashtu edhe midis profesionistëve të kujdesit shëndetësor që mund të vizitojnë pacientë të tillë. Për më tepër, është e rëndësishme që autoritetet e shëndetit publik të jenë të përgatitura për të kryer gjurmimin e kontakteve dhe masat e parandalimit dhe kontrollit të infeksionit, nëse diagnostikohen raste.

Rreziku i përgjithshëm mbetet i ulët për meshkujt që kryejnë marrëdhënie seksuale me meshkuj dhe i ulët për popullsinë më të gjerë të BE/EEA. Megjithatë, derisa tani fillojnë udhëtimet verore dhe sezoni i krenarisë, transmetimi mund të rritet dhe është e rëndësishme të rritet ndërgjegjësimi midis meshkujve që kryejnë marrëdhënie seksuale me meshkuj në kontekstin e mesazheve të përgjithshme mbi infeksionet seksualisht të transmetueshme.

Influenca A(H5N1) – Monitorimi i rasteve humane

Më 13 qershor 2025, Ministria e Shëndetësisë e Kamboxhias raportoi një rast të ri human të infeksionit nga virusi i gripit të shpendëve A(H5N1) në provincën Takeo, Kamboxhia. Prania e infeksionit të virusit A(H5N1) tek gruaja 65-vjeçare u konfirmua nga Instituti Pasteur i Kamboxhias më 12 maj 2025. Ajo u paraqit me ethe, kollë dhe gulçim dhe po trajtohet në një njësi kujdesi intensiv. Është raportuar ekspozim ndaj shpendëve të oborrit, megjithëse nuk janë zbuluar zogj të sëmurë ose të ngordhur në oborrin e familjes dhe as në fshat. Gjurmimi i kontakteve dhe hetimi për të identifikuar burimin e infeksionit janë duke vazhduar. Kamboxhia raportoi 77 raste njerëzore me infeksion të gripit të shpendëve A(H5N1), duke përfshirë 47 vdekje (CFR 60.5%) që nga viti 2003 dhe deri më 16 qershor 2025. Nga rastet e raportuara, pesë raste, duke përfshirë 4 vdekje, janë raportuar në vitin 2025.

Vlerësimi i ECDC

Rastet sporadike të nëntipeve të ndryshme të gripit të shpendëve A(H5Nx) janë raportuar më parë globalisht. Provat aktuale virologjike sugjerojnë që viruset A(H5N1) që qarkullojnë ruajnë karakteristika gjenetike në përputhje me viruset e gripit të adaptuara për shpendët. Duke pasur parasysh transmetimin e përhapur të viruseve të gripit të shpendëve tek kafshët, transmetimi tek njerëzit me gripin e shpendëve mbetet i rrallë dhe nuk është vërejtur asnjë transmetim i qëndrueshëm midis njerëzve. Në përgjithësi, rreziku i transmetimit të gripit zoonotik tek publiku i gjerë në vendet e BE/EEA-së konsiderohet i ulët. Rreziku për grupet e ekspozuara në punë, siç janë fermerët dhe prerësit e bagëtive, konsiderohet i ulët deri në të moderuar.

Kontakti i drejtpërdrejtë me zogjtë dhe kafshët e tjera të infektuara, sekrecionet e tyre ose një mjedis i kontaminuar është burimi më i mundshëm i infeksionit, dhe përdorimi i masave mbrojtëse personale për njerëzit e ekspozuar ndaj kafshëve të

ngordhura ose sekrecioneve të tyre do të minimizojë rrezikun e lidhur. Rastet e rënda të fundit në Azi dhe Amerikë tek fëmijët dhe njerëzit e ekspozuar ndaj shpendëve të infektuar, të sëmurë ose të ngordhur të oborrit nënvizojnë rrezikun e kontaktit të pambrojtur me zogjtë e infektuar në mjediset e fermave të oborrit. Kjo mbështet rëndësinë e përdorimit të pajisjeve të duhura mbrojtëse personale.

Klasifikimi i varianteve të SARS-CoV-2

Që nga përditësimi i fundit më 28 maj 2025, dhe që nga 27 qershori 2025, ndryshimet e mëposhtme janë bërë në klasifikimet e varianteve të ECDC për variantet shqetësuese (VOC), variantet me interes (VOI), variantet nën monitorim (VUM) dhe variantet e de eskaluara:

- XFG u shtua si një variant nën monitorim (VUM)
- KP.3 (më parë VOI) de eskaluar:
- XEC (më parë VUM) de eskaluar:

XFG është një pasardhës i LF.7, i cili nga ana tjetër rrjedh nga nën-linja BA.2.86 JN.1. Klasifikimi i VUM bazohet në prova të një shkalle rritjeje në krahasim me variantet e tjera që qarkullojnë globalisht, dhe në BE/EEA. Ndërsa ky klasifikim VUM shërben për të nxjerrë në pah evolucionin e një varianti të SARS-CoV-2 që po i tejkalon llojet e tjera, është shumë herët për të vlerësuar nëse XFG do të ketë ndonjë ndikim të konsiderueshëm epidemiologjik në BE/EEA, me qarkullimin aktual të SARS-CoV-2 në nivele të ulëta.

Aktualisht nuk ka prova të rritjes së ashpërsisë për XFG dhe nuk parashikohet asnjë ndikim i rëndësishëm në efektivitetin e vaksinës kundër sëmundjes së rëndë për vaksinat që janë aktualisht në dispozicion, megjithëse priten studime të mëtejshme laboratorike dhe klinike.

Vlerësimi i ECDC-së:

Transmetimi i ulët i SARS-CoV-2, raportimi i reduktuar dhe vëllimet e ulëta të testimit në sistemet sentinel kanë të gjitha një ndikim në aftësinë e ECDC-së për të vlerësuar me saktësi situatën epidemiologjike, duke përfshirë qarkullimin e varianteve.

Popullsia e BE/EEA-së në përgjithësi ka një nivel të konsiderueshëm të imunitetit (infeksion paraprak plus vaksinim/vaksinim përforcues), duke ofruar mbrojtje kundër sëmundjeve të rënda. Variantet që aktualisht qarkullojnë dhe që klasifikohen si VOI ose VUM nuk ka gjasa të shoqërohen me ndonjë rritje të ashpërsisë së infeksionit krahasuar me variantet që qarkullojnë më parë, ose një ulje të efektivitetit të vaksinës kundër sëmundjeve të rënda. Megjithatë, individët e moshuar, ata me sëmundje shoqëruese, dhe individët që nuk janë infektuar më parë mund të zhvillojnë simptoma të rënda nëse infektohen. Vaksinimi vazhdon të jetë masa mbrojtëse, kundër zhvillimit të formave të rënda, megjithëse ky efekt mbrojtës zbehet me kalimin e kohës. Vaksinimi i individëve me rrezik të lartë për forma të rënda (p.sh. të moshuarit) mbetet i rëndësishëm.

8. REKOMANDIMET

Për ngritjen e kualitetit të raportimit, mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse dhe aplikimin e masave parandaluese dhe kundërepidemike me kohë rekomandojmë:

Bazuar në Ligjin për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse Nr.08/L-200, Neni 20 dhe 21 të gjitha Institucionet shëndetësore obligohen të raportojnë në IKSHPK/QRSHP sipas listës së sëmundjeve ngjitëse Aneksi 1 i këtij ligji.

Raportimi i sëmundjeve të bëhet përmes sistemit të digjitalizuar të mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse në të gjitha nivelet me qëllim të sigurimit të të dhënave në kohë reale, të dhëna kualitative dhe pasqyrë reale të situatës epidemiologjike për parandalim dhe kontrollë të sëmundjes.

INSITUTI KOMËTAR I SHËNDETËSISË

PUBLIKE TË KOSOVËS

Departamenti i Epidemiologjisë

Adresa: Rr. Nëna Terezë (p.n) rrethi i spitalit, Prishtinë 10000

WebFaqe: <http://www.niph-rks.org>

E-mail: ariana.kalaveshi@rks-gov.net

Telefoni+38338 551432, ext. 1013



INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË PUBLIKE TË KOSOVËS
NATIONAL INSTITUTE OF PUBLIC HEALTH OF KOSOVA